



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Datë 30.09.2020

Dokument Parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR METROLOGJINË”

- ***Hyrje***

Komisioni për Integrimin Europian (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë **30.09.2020**, me cilësinë e Komisionit **për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin **“Për metrologjinë ”.**

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte e pranishme Ministria e Ekonomisë dhe e Financave e përfaqësuar nga Znj. Belinda Ikonomi, Zevendësministre.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Ky projektligj është nismë e Këshillit të Ministrave me propozim të Ministrisë së Brëndshme, në mbështetje të nenit 81, pika 1, të Kushtetutës.

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 78 dhe Rregullores së Kuvendit, neni 55 pika 1 ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Sipas nenit 2 të projektligjit, qëllimi i tij është të sigurojë:

- a) përdorimin e njësive matëse në përputhje me Sistemin Ndërkombëtar të Njësisë;
- b) gjurmueshmërinë e standardeve të matjes së Republikës së Shqipërisë ndaj standardeve ndërkombëtare dhe standardeve kombëtare të vendeve të tjera;
- c) matje uniforme në Republikën e Shqipërisë dhe besim në rezultatet e matjeve të kryera në funksion të tregut;
- ç) lëvizjen e lirë të instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara, të cilat janë objekt i markimit CE, dhe markimin metrologjik;
- d) lëvizjen e lirë të produkteve të parapaketuara, nëse ato kanë shenjën e konformitetit dhe harmonizimin e metodave për matjet dhe kontrollin metrologjik;
- dh) mbështetjen dhe zhvillimin e infrastrukturës së përshtatshme metrologjike që të sigurojë gjurmueshmërinë e rezultateve të matjes;
- e) drejtimin dhe financimin e aktiviteteve të kërkimit dhe zhvillimit në metrologji;
- ë) komunikim të shpejtë, të saktë dhe lehtësisht të kuptueshëm dhe shkëmbim informacioni mbi çështjet metrologjike;
- f) mbrojtjen e konsumatorëve dhe të shtetit nga rezultatet e pasakta të matjeve të instrumenteve matëse.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji, është konform normave kushtetuese dhe i harmonizuar me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare

OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Bazuar në nenin 68, pika 2 e Rregullores, projektligji në relacionin e tij nuk paraqet përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Axhenda e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së***

Përputhmëria më Acquis e Bashkimit European është e pjesëshme, specifikisht me

- Direktivën 2009/34/KE të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 23 Prill 2009 në lidhje me dispozitat e përbashkëta për instrumentet matës dhe për metodat e kontrollit metrologjik, e ndryshuar. Numri CELEX 32009L0034, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.106, datë 28.4.2009, fq.7-24.
- Direktivën 2007/45/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 5 Shtator 2007 “Mbi përcaktimin e rregullave për sasi të nominale për produktet e parapaketuara, që shfuqizojnë Direktivat e Këshillit 75/106/KEE dhe 80/232/KEE, dhe ndryshon Direktivën e Këshillit 76/211/KEE”. Numri CELEX 32007L0045, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.247, datë 21.9.2007, fq.17-20.
- Direktivën e Këshillit 75/107/KEE, datë 19 Dhjetor 1974 “Mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare, në lidhje me shishet që përdoren si enë matëse”. Numri CELEX 31975L0107, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.42, datë 15.2.1975, fq.14-20.
- Direktivën 2014/31/BE të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 “Mbi harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me vënien në dispozicion në treg të instrumenteve jo automatik të peshimit”. Numri CELEX 32014L0031, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.96, datë 29.3.2014, fq.107-148.

Direktivën e Këshillit 76/211/KEE, datë 20 Janar 1976 “Mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare, në lidhje me përbërjen sipas peshës ose volumit të produkteve të caktuara të parapaketuara”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31976L0211, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.46, datë 21.2.1976, fq.1-11

Plani Kombëtar për Integrimin European 2020-2022

- Ky projektligj është në përputhje me objektivat strategjikë dhe prioritetet e parashikuara në Kapitulli 1 “Lëvizja e lirë mallrave” të Planit Kombëtar për Integrimin European (**PKIE**) **2020-2022.**

Acquis e BE-së që përafrohet nga projektligji i propozuar:

Legjislacioni parësor i BE-së:

- *Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit European (TFBE): Pjesa e parë “ Parimet”, Titulli I “Kategoritë dhe fushat e kompetencës së Bashkimit European”, neni 4, pika 2, shkronja “a”; Pjesa e Tretë “Politikat dhe zhvillimet e brendshme të Bashkimit European”, Titulli I “Tregu i brendshëm”, neni 26 (ish-neni 14 TKE); Titulli II “Lëvizja e lirë e mallrave”, neni 28 (ish-neni 23 TKE); Titulli VII “Rregullat e përbashkëta për konkurrencën, tatimet dhe përafrimin e legjislacionit”, Kreu 3 “ Përafrimi i legjislacionit”, neni 114 (ish-neni 95 TKE); Titulli XV “Mbrojtja e konsumatorit”, neni 169 (ish-neni 153 TKE).*
- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE - Shqipëri (MSA): Titulli VI “Përafrimi i legjislacionit, zbatimi i ligjeve dhe rregullat e konkurrencës”, **neni 75** “Standardizimi, metrologjia, akreditimi dhe vlerësimi i përputhshmërisë”, **neni 76** “Mbrojtja e konsumatorit”.

Legjislacioni dytësor i BE-së:

- *Direktiva 2009/34/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 23 Prill 2009 në lidhje me dispozitat e përbashkëta për instrumentet matës dhe për metodat e kontrollit metrologjik, e ndryshuar.*
- *Direktiva 2007/45/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 5 Shtator 2007 “Mbi përcaktimin e rregullave për sasitë nominale për produktet e parapaketuara, që shfuqizon Direktivat e Këshillit 75/106/KEE dhe 80/232/KEE, dhe ndryshon Direktivën e Këshillit 76/211/KEE”.*
- *Direktiva e Këshillit 75/107/KEE, datë 19 Dhjetor 1974 “Mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare, në lidhje me shishet që përdoren si enë matëse”.*
- *Direktiva 2014/31/BE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 “Mbi harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me vënien në dispozicion në treg të instrumenteve jo automatik të peshimit”.*
- *Direktiva e Këshillit 76/211/KEE, datë 20 Janar 1976 “Mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare, në lidhje me përbërjen sipas peshës ose volumit të produkteve të caktuara të parapaketuara”, e ndryshuar”.*

Niveli i Përafrimit:

- Shkalla e përafrimit të projektligjit të paraqitur me *acquis* të BE-së është e pjesëshme. Pra, projektligji në fjalë është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të Acquis të BE-së të lartpërmendura, por nuk është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave.
- **Konsultimi publik**

Në mbledhjen e Komisionit për Integrimin European nuk ka patur përfaqësues të shoqërisë civile apo të grupeve të interesit

- *Efektet financiare të aktit*

Efektet financiare të projektligjit do të mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

- *Diskutimi në komision*

Nga komisioni u vlerësuan risitë e këtij projektligji.

- *Ndryshime të projektaktit (nen për nen)*

1. SHQYRTIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË DISPOZITAVE TË PROJEKTLIGJIT ME ACQUIS TË BE

Nga shqyrtimi i përputhshmërisë së projektligjit të propozuar me *acquis* të BE-së rezulton se për një përafrim më të saktë me legjislacionin dytësor të lartpërmendur është e nevojshme që në tekstin e tij të bëhen disa ndryshime si vijon:

1. Shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit të riformulohet si vijon:

“Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- Direktivën 2009/34/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 23 Prill 2009 në lidhje me dispozitat e përbashkëta për instrumentet matës dhe për metodat e kontrollit metrologjik, e ndryshuar. Numri CELEX 32009L0034, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.106, datë 28.4.2009, fq.7-24.
- Direktivën 2007/45/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 5 Shtator 2007 “Mbi përcaktimin e rregullave për sasi të nominale për produktet e parapaketuara, që shfuqizon Direktivat e Këshillit 75/106/KEE dhe 80/232/KEE, dhe ndryshon Direktivën e Këshillit 76/211/KEE”. Numri CELEX 32007L0045, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.247, datë 21.9.2007, fq.17-20.
- Direktivën e Këshillit 75/107/KEE, datë 19 Dhjetor 1974 “Mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare, në lidhje me shishet që përdoren si enë matëse”. Numri CELEX 31975L0107, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.42, datë 15.2.1975, fq.14-20.
- Direktivën 2014/31/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 “Mbi harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare në lidhje me vënien në dispozicion në treg të instrumenteve jo automatik të peshimit”. Numri CELEX 32014L0031, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.96, datë 29.3.2014, fq.107-148.
- Direktivën e Këshillit 76/211/KEE, datë 20 Janar 1976 “Mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare, në lidhje me përbërjen sipas peshës ose volumit të produkteve të caktuara të parapaketuara”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31976L0211, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr.46, datë 21.2.1976, fq.1-11.

2. Në nenin 3 të projektligjit, pika 26 të riformulohet si vijon:

“26. “Parapaketim”, kombinimi i një produkti dhe një paketimi individual **në të cilin është parapaketuar**. Një produkt është i **parapaketuar**, kur ai vendoset në **një paketim**, të çfarëdo

natyre qoftë, pa qenë blerësi prezent, dhe sasia e produktit që përmbahet në **paketim** ka një vlerë të paracaktuar dhe nuk mund të ndryshohet pa u hapur **paketimi** ose pa iu nënshtruar një modifikimi të perceptueshëm.”

3. Në nenin 18 të projektligjit, pika 2 të riformulohet si vijon:

“2. Instrumentet matëse, që janë objekt i markimit CE, vendosen në treg dhe/ose vihen në përdorim, nëse kanë markimin CE, Markimin Metrologjik Suplementar M **dhe** dy shifrat e fundit të vitit të prodhimit, **të rrethuara nga një drejtkëndësh lartësia e të cilit është e njëjtë me lartësinë e markimit CE**; numrin unik të trupës notifikuese që ka marrë pjesë **në fazën e kontrollit të prodhimit, i cili vendoset nga vetë trupa ose, sipas udhëzimeve të tij, nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar**, nëpërmjet së cilës, prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar ose importuesi garantojnë se instrumenti matës është në përputhje me kërkesat metrologjike të përshkruara”.

Përfundim

- Komisioni për Integrimin Europian:
 - pasi vlerësoi qëllimin e projektligjit, procedurat ligjore sipas detyrimeve kushtetuese dhe të Rregullores së Kuvendit;
 - pasi vlerësoi përputhshmerinë e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian si detyrim i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, neni 70;
 - pasi propozoi ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e dispozitave dhe
 - pasi konsideroi se projektligji votohet me mazhorancë të thjeshtë,
- e votoi** aktin ligjor të propozuar nga Këshilli i Ministrave në parim, nen për nen dhe me ndryshime në tërësi dhe me shumicë votash **e miratoi** atë dhe vendosi për vijimin e procedurës sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARE

RUDINA HAJDARI